

VENDIM
Nr. 226, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Ardjan Turku.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Voltana Ademi, deputet i zonës zgjedhore, qarku Shkodër, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 5 mandate.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Shkodër, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 5, është z. Gjovalin Bzhetaj.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Demokratike në qarkun e Shkodrës, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, i plotëson kriteret ligjore, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i përkonte kandidatës znj. Voltana Ademi, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrit”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PD-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore, qarku Shkodër, kandidatja e radhës në listë pas znj. Voltana Ademi është kandidatja me nr. rendor 10 (dhjetë), znj. Irma Musa Kopliku (Alushi). Sipas nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas znj. Voltana Ademi, që i përket gjinisë femërore, është kandidatja me nr. rendor 10 (dhjetë), znj. Irma Musa Kopliku (Alushi).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Shkodër, znj. Irma Musa Kopliku (Alushi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.